



Duke u mbështetur në nenin 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040. Nenit 3, Nenit 5, Nenit 6 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë i datës 21.12.2021, nenit 31, 32, 33 dhe 53 të Statutit të Komunës së Klinës /2010. Ligjit për barazi gjinore Nr. 05/L-020, Nenit 11 të Rregullores për Punë Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës /2011, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më datë: 28.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për

Themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, si komitet i përhershëm. Komiteti kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
2. Përbërja reflekton përfaqësimin e etnive politike dhe gjinore në Kuvendin e Komunës dhe ka këtë përbërje:
 1. Fadil Gashi - LDK, Kryesues
 2. Blerina Gashi - LDK, anëtare
 3. Tunë Dedaj - AAK, “
 4. Blerta Gashi - AAK, “
 5. Bledar Berisha - PDK, “
 6. Mende hije Duraku - PDK, “
 7. Valmire Krasniqi - VV, “
3. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve të tjera dhe se mandati i këtij komiteti është i lidhur me mandatin e anëtareve të Kuvendit
4. Përbërja e anëtarëve të KPF-së është shtatë (7) anëtarë të Kuvendit, të cilët do të kompensohen për punën e tyre sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2020
5. Përbërja dhe kompetencat e këtij Komiteti rregullohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si në hyrje të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
7. Me këtë vendim njoftohen: MPL, anëtarët e KPF-së, kryetari i komunës, drejtorja për financa ekonomi dhe zhvillim, arkivi i komunës dhe zyra për informim

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-3502 2022
Klinë, më dt. 02.02. 2022



Kryesuesi,
Fadil Gashi